



This project is
funded by the
European Union



European Bank
for Reconstruction and Development

**Programi Rajonal i Efiçencës së Energjisë të Ballkanit
Perëndimor, Faza II – Dritarja 1(a) e Dialogut të
Politikave
(REEP Plus)**

**Projekti: Shqipëri – Rishikimi dhe Përditësimi i Ligjit
kryesor të Efiçencës së Energjisë në Shqipëri**

Projektligj për ndryshime ligjore [Versioni 3.0]

15 Tetor 2019

Përmbajtja

Përmbajtja

1	Hyrje	Error! Bookmark not defined.
A1	Projekt ndryshimet në Ligjin për Eficiencën e Energjisë	2

1 Hyrje

Economic Consulting Associates Ltd (ECA) me mbështetjen e KALO & ASSOCIATES (Kalo) është kontraktuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim [European Bank for Reconstruction and Development (EBRD)] për të mbështetur Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë për Eficiencën e Energjisë (së bashku, “përfituesit”), për të ndryshuar Ligjin kryesor të Eficiencës së Energjisë me qëllim harmonizimin dhe përputhjen e tij me Direktivën 2012/27/BE të Bashkimit Evropian (BE), (“Direktiva e Eficiencës së Energjisë” ose “DEE”), siç është transpozuar për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

Direktiva e Eficiencës së Energjisë 2012/27/BE (DEE) është përshtatur dhe miratuar nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë në tetor 2015 dhe kishte si afat për përafrimin e saj datën 15 tetor 2017. Kjo Direktivë zëvendëson Direktivën e Shërbimeve Energjetike 2006/32/KE (DSE).

Ligji për Eficiencën e Energjisë në Shqipëri (referuar në këtë document si “Ligji aktual”) u miratua nëntor 2015 dhe ka përafruar shumicën e parashikimeve të DEE. Megjithatë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) ka identifikuar se disa elemente të DEE-së sërish mungojnë në Ligjin aktual, ndërkohë që një pjesë e mirë e akteve nënligjore të identifikuara, nuk janë finalizuar ende.

Objektivat e këtij projekti janë të asistojë përfituesit në mënyrë që të:

- o Rishikojë Ligjin për Eficiencën e Energjisë i cili do të përfshijë në mënyrën e duhur të gjitha aspektet e DEE, ose do të përcaktojë referenca të qarta në legjislacionin përkatës, kur përafrimi i këtyre aspekteve është kryer në mënyrë të mjaftueshme nga legjislacioni alternativ ekzistues. Kjo do të mbulojë përfshirjen e elementëve të cilët aktualisht mungojnë në Ligjin ekzistues për Eficiencën e Energjisë, duke përfshirë Nenin 4 (Strategjia e Rinovimit të Ndërtesave), Nenin 7 (Skemat Detyruese për Eficiencën e Energjisë dhe alternativat), Nenin 14 (promovimi i eficiencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje), Nenin 15 (transformimi, transmetimi dhe shpërndarja) dhe Nenin 24 (Raportimi).
- o Asistojë përfituesit gjatë rishikimit të mundësive të politikave të tyre në lidhje me përafrimin e DEE-së, specifikisht lidhur me ato nene të cilat aktualisht nuk janë trajtuar në legjislacionin ekzistues. Grupi do të asistojë përfituesit gjatë vlerësimit të mundësive, përcaktimit të qasjeve të nevojshme të politikave dhe rrjedhimisht, rishikimit të Ligjit për Eficiencën e Energjisë.

Një “Rishikim Diagnostikues” është ndërmarrë në nëntor 2018 për të identifikuar qëllimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin aktual, me qëllim arritjen e përputhshmërisë së plotë me DEE-në. Rishikimi Diagnostikues u diskutua në një takim informues në Tiranë, më 20 nëntor për të rënë dakord mbi qasjen lidhur me projektligjin për ndryshimet e para. Pjesa tjetër e këtij raporti përmban këtë draft të parë si Shtojcë e tij.

SHTOJCA

A1 Projekt ndryshimet në Ligjin për Eficencën e Energjisë

PROJEKTLIGJ

Nr.____/2019

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 124/2015, DATË 12.11.2015 “PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË”¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në Ligjin nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për eficiencyn e energjisë” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në Nenin 4 “Përkufizime”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 11 riformulohet si më poshtë:

“11. “Konsumator i madh i energjisë” është një konsumator fundor i cili në bazë të të dhënave të një procesi auditimi, rezulton se ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 1 milionë këh energji ekuivalente në vit.

2. Pas pikës 22, shtohet pika 22/1 me këtë përmbajtje:

“22/1. “Organet e Qeverisjes Qendrore” janë të gjitha drejtoritë administrative, kompetenca e të cilave shtrihet mbi të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”

3. Pika 27 riformulohet si më poshtë:

“27. “Rinovim i konsiderueshëm” ka kuptimin siç përkufizohet në Neni 3, pika 22 e Ligjit Nr.116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”, i ndryshuar.

4. Pika 29 riformulohet si më poshtë:

“29. “Shoqëria për Shërbime Energjetike (ESCO)” është një person fizik apo juridik që ofron shërbime energjetike apo masa të tjera të përmirësimit të eficiencyn së energjisë në objektet apo mjediset e konsumatorit fundor, me qëllim të përmirësimit të eficiencyn së energjisë në objekte të tilla, të cilët marrin përsipër një pjesë të rrezikut financiar për kryerjen e shërbimeve të ofruara.

¹Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2012/27/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Për eficiencyn e energjisë, që ndryshon Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizon Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE”. Numri CELEX-32012L0027, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.315/1, datë 14.11.2012.

Pagesa për shërbimet e ofruara (plotësisht apo pjesërisht) bazohet në përmirësimin e efijencës së energjisë dhe arritjen e kriterëve të performancës së paracaktuar.”

5. Pas pikës 30, shtohet pika 31 me këtë përmbajtje:

“31. “Autoritetet publike” janë “autoritetet kontraktuese” siç përkufizohen në legjislacionin e zbatueshëm shqiptar mbi prokurimet publike.”.

Neni 2

1. Neni 6 riformulohet si më poshtë:

“Neni 6

Objektivi Kombëtar Tregues i Kursimit të Energjisë

1. Këshilli i Ministrave, duke marrë në konsideratë çdo angazhim të vendit tonë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, duhet të vendosë një objektiv kombëtar të kursimit të energjisë, që bazohet në mundësitë reale ekonomike, konsumin primar ose atë final të energjisë, kursimin e energjisë primare ose finale, apo në intensitetin e energjisë. Ky objektiv kombëtar i kursimit të energjisë përcaktohet në Planin Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë, ose në çdo plan tjetër të integruar i cili do të draftohet në të ardhmen lidhur me energjinë, efijencën e energjisë dhe/ose klimën, që do të zëvendësojë apo përthithë Planin aktual Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë, dhe i njoftohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë sipas rregullave të përcaktuara në Nenin 7, pika 1 e këtij Ligji.
2. Objektivi kombëtar i kursimit të energjisë i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, arrihet përmes masave që synojnë rritjen e efijencës së energjisë ndërmjet sektorëve individuale të ekonomisë kombëtare, duke përfshirë sektorët e shërbimeve dhe atë rezidencial, sektorin e industrisë, sektorin publik, sektorin e transportit dhe masa të tjera ndër-sektoriale.”

Neni 3

1. Në Nenin 8, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi 6 me këtë përmbajtje:

“6. Agjencia për Efijencën e Energjisë publikon në faqen e saj zyrtare rregullisht, të gjitha raportet e përgatitura sipas parashikimeve të paragrafëve 3, 4 dhe 5 më sipër të këtij Neni, në mënyrë që të mundësojë zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë. Të gjitha veprimtaritë e monitorimit dhe të raportimit të kryera nga Agjencia për Efijencën e Energjisë raportohen në një bazë të centralizuar të dhënash, të miratuar, që lidhet me monitorimin dhe verifikimin.”

Neni 4

1. Neni 9 riformulohet si më poshtë:

“Neni 9

Masat për efijencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike

1. Këshilli i Ministrave, përcakton përmes një vendimi, masat specifike që lidhen me detyrimin e autoriteteve publike për t'i dhënë prioritet gjatë blerjes, produkteve dhe shërbimeve të cilat kanë një nivel më të lartë të efijencës së energjisë, për sa kohë që kjo është në përputhje me efektivitetin e kostove, fizibilitetin ekonomik, mbështetjen më të gjerë, përshtatshmërinë teknike, dhe për sa kohë kjo lejon mjaftueshmërisht konkurrencën, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës për prokurimet publike.
2. Këshilli i Ministrave, përcakton përmes një vendimi, metodologjinë që shërben për të llogaritur kriteret teknike lidhur me nivelin e efijencës së energjisë që përdoret nga autoritetet publike gjatë prokurimit publik të produkteve dhe shërbimeve të detyrueshme sipas paragrafit 1 të këtij Neni. Këto kriteret aplikohen pavarësisht faktit nëse çmimi më i ulët i ofruar apo oferta ekonomike më e favorshme do të përdoret si kriter për përcaktimin e ofertës fituese. Kriteret i referohen standardeve ndërkombëtare dhe/ose Evropiane, të aplikueshme për të gjitha pajisjet dhe produktet që blihen nga autoritetet publike në Shqipëri, për sa kohë që kjo gjë është në përputhje me efektivitetin e kostove, mundshmërinë ekonomike, mbështetjen më të gjerë, përshtatshmërinë teknike, dhe për sa kohë lejon mjaftueshmërisht konkurrencën, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij Neni. Nëse për një produkt të veçantë nuk ka asnjë standard shqiptar të aplikueshëm për efijencën e energjisë, zbatohen standardet përkatëse teknike në fuqi të Bashkimit Evropian për këtë produkt të veçantë.
3. I njejtë vendim i cili përcaktohet në paragrafin 2 më sipër të këtij Neni, përfshin një metodologji për mundësinë e aplikimit të pikëve shtesë që jepen nga autoritetet publike, ndaj ofertuesve të cilën tejkalojnë standardet minimale të efijencës së energjisë të përcaktuara në të, në rast se qasja e ofertës ekonomike më të favorshme do të përdoret si kriter për përcaktimin e ofertës fituese.
4. Të njejtat rregulla prokurimi të cilat miratohen nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Neni, përcaktojnë detyrimin e autoriteteve publike që t'i japin prioritet agregatit të efijencës së energjisë në rast se blejnë një paketë produktesh si një të vetme, në krahasim me efijencën e energjisë së produkteve individuale brenda asaj pakete, duke blerë në këtë mënyrë paketën e produktit që përputhet me kriterin që i përket klasës më të lartë të efijencës së energjisë, pa anashkaluar megjithatë kushtin e përmbushjes së standardeve minimale për të gjitha produktet dhe shërbimet individuale.

Neni 5

1. Pas Nenit 9, shtohet Neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Masat ndër sektoriale

1. Masat ndër sektoriale përcaktohen në Planin Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë, ose në çdo plan tjetër të integruar i cili do të draftohet në të ardhmen lidhur me energjinë, efijencën dhe/ose klimën, që do të zëvendësojë apo përthithë Planin aktual Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë, sipas parashikimeve të Nenit 7 të Ligjit për Efijencën e Energjisë. Këto masa zbatohen nga subjektet publike dhe private përgjegjëse dhe përfshijnë, ndër të tjera:
 - a) miratimin e standardeve dhe normave, që synojnë, para së gjithash, përmirësimin e efijencës së energjisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe përmirësimet në ndërtesa;
 - b) skemat e etiketimit të energjisë;

- c) matjen, sistemet inteligjente të matjes, të tilla si pajisjet individuale të matjes, të menaxhuara nga larg dhe sistemet informuese të faturimit;
 - ç) trajnimin dhe edukimin, që çon në aplikimin e teknologjisë dhe/ose teknikave të efijencës së energjisë;
 - d) rregulloret, taksat, që kanë efektin e reduktimit të konsumit final të energjisë;
 - dh) fushatat që fokusohen në informimin dhe promovimin e përmirësimit të efijencës së energjisë dhe masat që duhen ndërmarrë, me qëllim përmirësimin e efijencës së energjisë.
2. Agjencia për Efijencën e Energjisë mundëson bashkëpunimin dhe diskutimet mes subjekteve publike dhe private gjatë miratimit të masave ndër sektoriale të përmendura në paragrafin 1 të këtij Neni”.

Neni 6

1. Pas Nenit 9/1, shtohen Nenet 9/2 dhe 9/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/2

Rinovimi i ndërtesave

1. Një plan veprimi afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, atyre publike dhe atyre tregtare, qofshin këto publike dhe private miratohet si pjesë përbërëse e Planit Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë, ose e çdo plani tjetër të integruar i cili do të draftohet në të ardhmen lidhur me energjinë, efijencën dhe/ose klimën, që do të zëvendësojë apo përthithë në Planin aktual Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë. Ky plan veprimi afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, atyre publike dhe atyre tregtare, qofshin këto publike dhe private përfshin:
- a) një vështrim të përgjithshëm të stokut të ndërtesave në nivel kombëtar, siç vlerësohet e nevojshme, bazuar në të dhëna statistikore;
 - b) identifikimin e qasjeve kosto-efektive për rinovimet që lidhen me llojin e ndërtesës dhe zonën klimatike;
 - c) politikat dhe masat për stimulimin e rinovimeve kosto-efektive të ndërtesave;
 - ç) një perspektivë të orientuar nga e ardhmja që drejton vendimet e investimeve të individëve, industrisë së ndërtimit dhe institucioneve financiare;
 - d) një vlerësim të bazuar në prova të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera.
2. Plani i veprimit afatgjatë për mobilizimin e investimeve për rinovime të stokut kombëtar të ndërtesave të banimit, atyre publike dhe atyre tregtare, qofshin këto publike dhe private miratohet një vit pas miratimit të këtij Ligji dhe i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë, siç kërkohet në përputhje me paragrafin 1 të Nenit 7 të këtij ligji dhe plani i veprimit do të përditësohet çdo 3 (tre) vjet pas kësaj.

Neni 9/3

Roli shembullor i ndërtesave të Organeve të Qeverisjes Qendrore

1. Këshilli i Ministrave miraton një vendim që detyron sektorin publik të sigurojë se duke filluar nga [data të propozohet nga MIE/përfituesit], [përqindja të propozohet nga MIE/përfituesit], minimalisht 1% (një përqind) e sipërfaqes totale të kateve të ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje në pronësi dhe shfrytëzim organet e qeverisjes qendrore, të rinovohet çdo vit, për të përmbushur të paktën kërkesat minimale për performancën e energjisë, të cilat janë vendosur në zbatim të Nenit 7 të Ligjit no. 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa.

Ky vendim i Këshillit të Ministrave , përfshin:

- a) një metodologji të veçantë që përdoret për përcaktimin dhe llogaritjen e përqindjes përkatëse,
 - b) kufijtë lidhur me sipërfaqen totale të kateve të ndërtesave,
 - c) llojin e ndërtesave që kërkohet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 dhe të atyre të përjashtuara nga ky detyrim,
 - ç) zbatueshmërinë mbi ndërtesat e shfrytëzuara nga organet e qeverisjes qendrore dhe/ose departamentet administrative të një niveli qeverisës nën qeverisjen qendrore, dhe
 - d) masa të tjera të cilat zbatohen për të mundësuar rinovimin tërësor të ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore, në përputhje me parashikimet e paragrafit 1 më sipër.
2. Ministri përcakton dhe publikon inventarin e ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje të organeve të qeverisjes qendrore, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 250 m² (dyqind e pesëdhjetë metra katror), pa përfshirë këtu ndërtesat e përjashtuara sipas paragrafit 3 më poshtë. Inventari duhet të përfshijë:
 - a) sipërfaqen totale të kateve në m² (metra katror), dhe
 - b) performancën e energjisë të secilës ndërtesë ose të dhënat përkatëse që lidhen me energjinë.
 3. Kategoritë e mëposhtëme të ndërtesave përjashtohen nga detyrimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 më sipër:
 - a) ndërtesat që zyrtarisht mbrohen si pjesë e një mjedisi të caktuar apo për shkak të karakteristikave të tyre të veçanta arkitekturore ose historike, për aq kohë sa përmbushja e kërkesave minimale të performancës së energjisë do të ndryshonte karakterin ose paraqitjen e tyre në mënyrë të papranueshme;
 - b) ndërtesat në pronësi të forcave të armatosura ose organeve të qeverisjes qendrore dhe që i shërbejnë qëllimeve të mbrojtjes kombëtare, përveç banesave individuale të banimit ose ndërtesave të zyrave të forcave të armatosura dhe stafin tjetër të punësuar nga autoritetet kombëtare të mbrojtjes; dhe
 - c) ndërtesat që përdoren si objekte kulti dhe ato për aktivitete fetare.
 4. Me qëllim përgatitjen e inventarit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij Neni, Ministri dorëzon një kërkesë për dhënie të informacionit të nevojshëm sipas paragrafit 3, subjekteve përkatëse të sektorit publik të cilat janë të detyruara të japin informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar.
 5. Vendimi i Këshillit të Ministrave i përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni, përcakton si objektiv ndërtesat e organeve të qeverisjes qendrore me performancën më të dobët të energjisë, të cilat kanë përparësi lidhur me masat për efikasitetin e energjisë, kur kjo është e mundur si nga pikëpamja e kostos-efektive ashtu edhe teknikisht e realizueshme.

6. Përmbajtja e vendimit të Këshillit të Ministrave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, hartohet në përputhje me përmbajtjen e strategjisë afatgjatë të përshkruar në Nenin 9/2.
7. Këshilli i Ministrave merr masat për të siguruar fondet e nevojshme për zbatimin e vendimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.”.

Neni 7

1. Pas Nenit 11, shtohet Neni 11/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Skema detyruese për eficiency dhe masat alternative

1. Me qëllim arritjen e përdorimit racional dhe eficient të burimeve të energjisë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikën e eficiency së energjisë të vendosur sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit përgjegjës, miraton objektivat e kursimeve kumulative të konsumit final të energjisë në nivel kombëtar për t’u arritur deri në 31 dhjetor 2030.
2. Me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni dhe përmes një udhëzimi të tij, Ministri harton një plan pune i cili përcakton masat e politikave që do të miratohen. Kjo do të marrë në konsideratë:
 - a) masat e politikave të planifikuara dhe atyre operationale të përshkruara në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiency e Energjisë, për të cilat qëllimi kryesor janë përmirësimet e konsumit final të energjisë; dhe
 - b) krijimi i Skemës Detyruese për Eficiency e Energjisë.
3. Me qëllim arritjen e objektivave kombëtarë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni dhe që i atribuohen planit të përcaktuar në Paragrafin 2(b) të këtij Neni, një Skemë Detyruese për Eficiency e Energjisë miratohet nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave, për operatorët e sistemeve të shpërndarjes dhe/ose furnizuesit e tregut të energjisë në Republikën e Shqipërisë me qëllim arritjen e kursimeve në konsumin final të energjisë.
4. Udhëzimi përkatës i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Neni do të përfshin:
 - a) metodologjinë për llogaritjen dhe volumet e përcaktuara në mënyrë shumë të saktë të kursimeve vjetore në konsumin final të energjisë, të nevojshme për të vendosur objektivat kombëtare të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni;
 - b) një listë të masave të politikave, të ndryshme nga skema detyruese për eficiency e energjisë (“masat alternative”), të cilat kontribuojnë në drejtim të objektivave kombëtare dhe në kursimet e pritshme të konsumit final të energjisë, të cilat i atribuohen secilës prej këtyre masave alternative;
 - c) një listë të burimeve të energjisë për të cilat shpërndarësit dhe/ose furnizuesit në tregjet e energjisë, detyrohen sipas Skemës Detyruese për Eficiency e Energjisë;
 - ç) rregullat në lidhje me raportimin, monitorimin dhe verifikimin e kursimeve të arritura nga shpërndarësit dhe/ose furnizuesit në tregjet e energjisë, që janë të detyruar sipas Skemës Detyruese për Eficiency e Energjisë; dhe
 - d) rregullat në lidhje me raportimin, monitorimin dhe verifikimin e kursimeve nga zbatimi i masave alternative të përmendura në paragrafin 5 më poshtë të këtij Neni.
5. Masat alternative të përmendura në paragrafin 4 mund t’i referohen:

- a) zhvillimit dhe zbatimit të programeve të ndryshme shtetërore në fushën e efijencës së energjisë;
 - b) taksa apo pagesa për çlirim të gazeve me efekt serë (taksa ekologjike);
 - c) mbështetje shtetërore dhe/ose masa stimuluese taksash për të inkurajuar zbatimin e teknologjive të efijencës së energjisë dhe reduktimin e konsumit final të energjisë;
 - ç) marrëveshjet vullnetare me qëllim të zbatimit të teknologjive të efijencës së energjisë të cilat çojnë në reduktimin e konsumit final të energjisë;
 - d) miratimin e standardeve, rregullave dhe rregulloreve të cilat përmirësojnë efijencën e energjisë së mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë ndërtesat dhe automjetet, përjashtuar rastet kur këto janë të detyrueshme në përputhje me angazhimet e marra përsipër sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
 - dh) prezantimin e rregullave për etiketimin e energjisë për produkte të lidhura të energjisë, përveç rasteve kur kjo është e detyrueshme në përputhje me angazhimet e marra përsipër sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
 - e) trajnimin dhe konsultimin lidhur me efijencën e energjisë, duke simuluar aplikimin e teknologjive të efijencës së energjisë dhe reduktimin e konsumit final të energjisë;
 - ë) masa të tjera që ndikojnë në arritjen e kursimit të konsumit final të energjisë.
6. Ministri administron skemën detyruese për efijencën e energjisë monitoron zbatimin e rregullave dhe dispozitave detyruese sipas udhëzimit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Neni.
 7. Objektivat kumulativë të kursimit për konsumatorët fundorë të cituara në pikën 1 të këtij Neni dhe të përcaktuara në planin e cituar në pikën 2 të këtij Neni, specifikohen Planin e Veprimit Kombëtar të Efijencës së Energjisë, ose në çdo plan tjetër të integruar i cili do të aprovohet në të ardhmen në lidhje me energjinë, efijencën e energjisë dhe/ose çështjet klimaterike, të cilat do të zëvendësojnë ose përthithin Planin e Veprimit Kombëtar të Efijencës së Energjisë.”

Neni 8

1. Neni 12 riformulohet si më poshtë:

“Neni 12

Marrëveshjet vullnetare

1. Marrëveshjet vullnetare miratohen nga Agjencia për Efijencën e Energjisë dhe konsumatorët e mëdhenj të energjisë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme industriale, pronarët e ndërtesave, për të mbështetur zbatimin e masave të efijencës së energjisë dhe aktiviteteve të efijencës së energjisë.
2. Marrëveshjet vullnetare të përmendura në paragrafin 1 më sipër janë transparente, jodiskriminuese dhe përmbajnë të paktën:
 - a) Detyrimet dhe objektivat specifike të çdo subjekti për zbatimin e masave të efijencës së energjisë;

- b) Metodologjinë që zbatohet për vlerësimin e kursimeve;
 - c) Të drejtën e Agjencisë për monitorimin e masave të efikasitetit të energjisë dhe detyrimin e palës tjetër për raportim;
 - d) Sanksionet në rast të mospërbashkimit të detyrimeve dhe procedurave zgjidhjes së kontratës;
 - e) Pika të tjera;
3. Agjencia ose çdo palë e tretë e pavarur e emëruar nga kjo e fundit, mund të marrë përsipër të kryejë një vlerësim të kostos dhe të përfitimit për marrëveshjen e propozuar vullnetare në mënyrë që të konfirmojë efikasitetin e kostos.
 4. Çdo marrëveshje vullnetare e nënshkruar sipas këtij Neni ka efekt vetëm pas miratimit të Ministrit përgjegjës për energjinë.
 5. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë ndërmerr aktivitete sensibilizimi me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për përfitimet nga Marrëveshjet Vullnetare dhe nxit subjektet e mundshme të marrin pjesë në këto marrëveshje”.

Neni 9

1. Në Nenin 14 pas paragrafit të parë të tij, shtohen paragrafët 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 14

1/1. Për qëllime të matjes së konsumit aktual, përfshirë këtu rastin e matjes dhe faturimit të konsumit individual në rastet e burimeve qendrore të ngrohjes ose ftohjes në ndërtesa me shumënjësi, ambjente individuale familjare të tillë si apartamente e vila, të furnizuara nga rrjeti i ngrohjes ose ftohjes qendrore ose nga një burim qendror ngrohjeje i instaluar dhe që i shërben vetëm kësaj ndërtese, qoftë në sektorin e energjisë elektrike, ashtu edhe në atë të gazit natyror, apo nga një impiant i prodhimit të energjisë termale, instalohen sisteme matësish inteligjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e energjisë dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e gazit natyror.

1/2. Të gjitha faturat për energjinë elektrike të konsumuar dhe/ose materiale promovuese të lëshuara nga furnizuesi, përmbajnë informacione të qarta në përputhje me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sektorin e energjisë dhe parashikimet e zbatueshme të legjislacionit në fuqi për sektorin e gazit natyror. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë bashkëpunon dhe koordinon punën me Entin Rregullator të Energjisë Elektrike lidhur me transparencën dhe informacionin që duhet të përfshihet në faturat përkatëse që do t'i lëshohen të gjithë konsumatorëve fundorë në lidhje me konsumin aktual të tyre, sipas këtij Neni.”

Neni 10

1. Në Nenin 15, paragrafi 2 riformulohet si më poshtë:

“Neni 15

2. Agjencia për Eficiencën e Energjisë merr masa për të promovuar dhe lehtësuar përdorimin eficient të energjisë nga konsumatorët e vegjel të energjisë, përfshirë këtu konsumatorët shtëpiakë. Këto masa përfshijnë një ose disa nga elementët e listuar më poshtë:

- (a) një sërë instrumentash dhe politikash për të promovuar ndryshimin e sjelljes së konsumatorit që mund të përfshijë:
 - (i) mundësi për të përfituar financim, grante ose subvencione;
 - (ii) dhënie informacioni;
 - (iii) projekte shëmbullore;
 - (iv) aktivitete në vendin e punës;
- (b) mënyra dhe mjete për të angazhuar konsumatorët dhe grupimet e konsumatorëve gjatë instalimit fillestar të matësave inteligjentë përmes komunikimit të:
 - (i) ndryshimeve me kosto-efektive dhe lehtësisht të arritshme në përdorimin e energjisë;
 - (ii) informacion për masat e eficiencës së energjisë.”

Neni 11

1. Pas Nenit 15, do të shtohet një Nen i ri 15/1 si më poshtë:

“Neni 15/1

Promovimi i eficiencës së energjisë në ngrohje dhe furnizim

1. Për të promovuar eficiencën e energjisë në ngrohje dhe ftohje, përfshirë kogjenerimin me efikasitet të lartë, Ministria përgjegjëse për energjinë deri më [data], kryen një vlerësim gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e kogjenerimit me eficiencë të lartë dhe ngrohjes dhe ftohjes eficiente. Elementet dhe kërkesat e një vlerësimi të tillë do të rregullohen nëpërmjet Udhëzimit të Ministrit i cili të miratohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni, do të bazohet në analizën e kostos dhe përfitimit që do të marrë në konsideratë kushtet klimaterike, fizibilitetin ekonomik dhe përshtatshmërinë teknike, me qëllim identifikimin e zgjidhjeve eficiente për plotësimin e nevojave për ngrohje, ftohje dhe energji elektrike. Analiza e kostos dhe përfitimit përgatitet në përputhje me metodologjinë e përcatkuar në Udhëzimin e Ministrit cituar në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni dhe analiza e përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni identifikojnë një mundësi për aplikimin e kogjenerimit me eficiencë të lartë dhe/ose njësi qendrore të ngrohjes dhe ftohjes, përfitimet e të cilave tejkalojnë kostot, Ministria i propozon Qeverisë të miratojë masat e përshtatshme, sipas rastit, për mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës eficiente të njërive qendrore të ngrohjes ose ftohjes, ose kogjenerimin me eficiencë të lartë përfituar nga çlirimi i nxehtësisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë. Për këtë qëllim, Ministria bashkëpunon ngushtësisht me autoritetet bashkiake”.

Neni 12

Në Nenin 17, bëhen këto ndryshime:

1. “Paragrafi 1 i Nenit 17 riformulohet si më poshtë:

“1. Auditimi energjistik, në kuptim të këtij Ligji, kryhet nga një auditues energjistik i pavarur ose një grup audituesish, të cilët janë të regjistruar në regjistrin elektronik të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë dhe të licensuara apo certifikuar apo akredituar. Procedura e çertifikimit të Audituesit Energjetik miratohet nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit, për secilin nga kategoritë e mëposhtme të Audituesve Energjistikë:

- a) Auditues Energjistikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha kategoritë e ndërtesave: rezidenciale, ndërtesa publike të pushtetit lokal dhe qendror dhe ndërtesa tregtare;
- b) Auditues Energjistikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha sipërmarrjet industriale duke përfshirë këtu centralet e transformimit të energjisë;
- c) Auditues Energjistikë që kryejnë auditime energjetike në të gjitha mjetet e sektorit të transportit.

Agjencia për Efiçencën e Energjisë mban në çdo kohë regjistrin e përditësuar të audituesve të energjisë, të çertifikuar dhe/ose akredituar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të përcaktuar në këtë paragraf, si dhe publikon dhe/ose përditëson këtë listë në faqen e saj zyrtare të internetit.

Auditimet energjetike nuk përfshijnë dispozita që pengojnë rezultatet e auditimit të transferohen te një ofrues i shërbimeve energjetike, bazuar në kushtin që konsumatori të mos ketë vërejtje në lidhje me këtë.”

1. Pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 1/1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Vendimi i Këshillit të Ministrave i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, rregullon të paktën sa më poshtë:

- a. Kategoritë dhe kërkesat minimale të kualifikimit të audituesve energjistikë së bashku me autorizimin e tyre për të kryer auditime në objekte të ndryshme;
- b. Përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e institucioneve të miratuara të edukimit dhe/ose trajnimit, të cilat janë të autorizuar të kryejnë trajnime, duke përfshirë kualifikimet minimale, kapacitetet dhe objektet që këto institucione duhet të zotërojnë;
- c. Një listë të trajnimeve të detyrueshme profesionale që duhet të përfshijnë të paktën trajnimin për legjislacionin përkatës kombëtar, standardet europiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit energjistik dhe manaxhimit energjik, trajnime teknike lidhur me teknikat e auditimit energjistik, teknikat e analizës së kostove, teknikat e shkrimit të një raporti auditimi etj.;
- ç) Parashikimin e kryerjes së provimeve përfundimtare, vlerësimin e rezultateve dhe çertifikimin e atyre që kanë përfunduar me sukses programet e trajnimit;
- d. Rregulla procedurale për lëshimin e liçensave apo çertifikatave audituesve të çertifikuar energjistik;
- dh) Rregulla procedurale për akreditimin/njohjen e audituesve të certifikuar energjik të huaj;
- e. Kodi i sjelljes i audituesve energjistikë;
- ë) Raportimet e detyrueshme në Agjencinë për Efiçencën e Energjisë;
- f. Metodrat dhe procedurat për të krijuar dhe mirëmbajtur regjistrin elektronik të auditimeve energjetike dhe audituesve energjetik;

- g. Metodrat dhe procedurat për kontrollin e cilësisë së auditimeve energjike dhe audituesve energjitikë, bazuar në kontrollin të paktën të një përqindjeje të konsiderueshme statistikore të raporteve të auditimit energjik që ata realizojnë;
- gj) Vendosjen e kriterëve minimale transparente dhe jodiskriminuese për të garantuar cilësinë e lartë të auditimeve energjike dhe sistemeve të manaxhimit energjetik;
- h. Arsytet dhe procedurat për revokimin e përhershëm dhe heqjen nga regjistri të audituesve, për shkak të performancës së dobët dhe/ose shkeljes së kodit të sjelljes.”

2. Pas paragrafit 1/1 të Nenit 17, shtohet paragrafi 1/2 me këtë përmbajtje:

“1.2 Auditimet energjike nuk përfshijnë dispozita që pengojnë rezultatet e auditimit të transferohen te një ofrues i shërbimeve energjetike, bazuar në kushtin që klienti/konsumatori të mos ketë vërejtje në lidhje me këtë.”

Neni 13

3. Neni 18 riformulohet si më poshtë:

“Neni 18

Shërbimet energjetike

- 1. Shërbimet energjetike ofrohen nga shoqëri të specializuara për shërbimet energjetike (ESCO), të cilat duhet të jenë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të licencuara ose çertifikuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për Eficiencën e Energjisë. Ministria përgjegjëse për energjinë publikon dhe përditëson në faqen e saj zyrtare të internetit një listë të ofruesve të disponueshëm të shërbimeve energjetike.
- 2. Shërbimet energjetike ofrohen në përgjithësi mbi bazën e kontraktimit të performancës energjetike, sipas një modeli kontrate, i cili do të miratohet përmes një udhëzimi të Ministrit, me propozimin e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë.
- 3. Deri në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Neni, kontrata e performancës së energjisë duhet të përmbajë të paktën rregullimet e mëposhtme:
 - a) Përcaktimin e qartë të gjendjes referuese para investimit, në bazë të të cilës do të maten dhe verifikohen kursimet e energjisë;
 - b) Listën e qartë dhe transparente të masave të eficiencës që duhet të realizohen ose rezultatet e eficiencës që do të arrihen;
 - c) Kursimet e garantuara që do të arrihen duke realizuar masat e kontratës;
 - ç) Kohëzgjatjen dhe fazat e kontratës, afatet dhe periudha e njoftimit;
 - d) Listën e qartë dhe transparente të detyrimeve të secilës palë kontraktuese;
 - dh) Datën(at) referencë për të vendosur kursimet e arritura;
 - e) Listën e qartë dhe transparente të hapave që duhen ndjekur për të zbatuar një masë ose paketë masash dhe, sipas nevojës, shpenzimet përkatëse;

- e) Detyrimin për të zbatuar në tërësi masat në kontratë dhe dokumentimin e të gjitha ndryshimeve të bëra gjatë projektit;
 - f) Rregulloret që specifikojnë përfshirjen e kërkesave ekuivalente në çdo nënkontraktim me palët e treta;
 - g) Paraqitjen e qartë dhe transparente të implikimeve financiare të projektit dhe alokimin e pjesëmarrjes së të dy palëve në kursimet e arritura monetare (siç është kompensimi i ofruesit të shërbimit);
 - gj) Dispozita të qarta dhe transparente për matjen dhe verifikimin e kursimeve të garantuara të arritshme, kontrollet e cilësisë dhe garancitë;
 - h) Dispozitat që qartësojnë procedurën për të trajtuar ndryshimin e kuadrit të kushteve që ndikojnë në përmbajtjen dhe rezultatin e kontratës (siç janë ndryshimi i çmimeve të energjisë, intensiteti i përdorimit të një instalimi);
 - i) Informacion të detajuar mbi detyrimet e secilës palë kontraktuese dhe penalitetet e aplikueshme në rastin e shkeljes së tyre.
4. Agjencia për Eficiencën e Energjisë publikon në faqen e saj të internetit:
- a) praktikat më të mira për kontraktimin e performancës së energjisë, udhëzimet, kontratat model përfshirë dispozitat që duhet të përfshihen në kontrata të tilla për të garantuar kursimet e energjisë dhe të drejtat e konsumatorëve fundorë;
 - b) listën e ofruesve të kualifikuar/regjistruar të shërbimeve energjetike, që duhet të përditësohet rregullisht; dhe
 - c) informacion mbi çdo instrument financiar në dispozicion, masa stimuluese, grante dhe kredi për të mbështetur projektet e shërbimeve të eficiencës së energjisë.
5. Agjencia për Eficiencën e Energjisë siguron një shqyrtim cilësor në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë lidhur me zhvillimin aktual dhe të ardhshëm të tregut të shërbimeve energjetike.

Neni 14

1. Pas Nenit 18, do të shtohet një Nen i ri 18/1 si më poshtë:

Neni 18/1

Eficienca e energjisë në transformim, transmetim dhe shpërndarje

1. Operatorët e sistemit të transmetimit, operatorët e shpërndarjes, shpërnadrësit e energjisë dhe shitësit e energjisë me pakicë, janë të detyruar të tërhiqen nga çdo aktivitet që mund të pengojë kërkesën dhe ofrimin e shërbimeve energjetike ose masave të tjera të përmirësimit të eficiencës së energjisë, ose pengojë zhvillimin e tregjeve për shërbime apo masa të tilla, duke përfshirë mbylljen e tregut për konkurrentët ose abuzimin me pozitat dominuese.
2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike sigurojnë heqjen e atyre masave stimuluese në tarifatat e transmetimit dhe shpërndarjes që dëmtojnë eficiencën e përgjithshme (përfshirë eficiencën e

energjisë) të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike ose ato që mund të pengojnë pjesëmarrjen e kërkesë ofertes, në balancimin e tregjeve dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

3. Operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes kryejnë auditime energjitike vjetore të humbjeve teknike në operatorin e sistemit të rrjetit dhe zbaton masat e nevojshme të efikasitetit të energjisë. Këto masa merren parasysh në planin e investimeve të operatorit të sistemit të transmetimit në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
4. Operatori i sistemit të transmetimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 43 / 2015 datë 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ndërmon masat e nevojshme për zbatimin e matësve inteligjentë duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet afatgjata për tregun .

Neni 15

1. Nenet 19-25 shfuqizohen.

Neni 16

1. Në Nenin 28 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rast se ndonjë parashikim në fuqi i legjislacionit ekzistues për sektorin e energjisë dhe legjislacionit ekzistues për sektorin e gazit natyror, që referohet në këtë ligj, do t’i nënshtrohet ndonjë ndryshimi(ve), ndreqjeje, shtese(ave) apo do të shfuqizohet në të ardhmen, këto ndryshime duhet të reflektohen menjëherë në parashikimet përkatëse të këtij ligji.”

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz Ruçi

Miratuar në [dita].[muaji].2019